



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR”

Niveli IV në KSHK¹ , referuar nivelit IV të KEK ²

K-U-IV-25

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	5
Kodi.....	5
Kohëzgjatja	5
Niveli.....	5
Qëllimi:	5
Kriteret e përgjithshme të pranimi:	5
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	5
Data e validimit.....	5
Data e miratimit	5
Variantet e mëparshme	5
Struktura e kualifikimit	6
Kompetenca të përgjithshme.....	6
NjN-14-IV-0333-25 Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës në shërbime kujdesi për të moshuar	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-14-IV-0334-25 Sigurimi i higjienës për të moshuarit	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-14-IV-0335-25 Anatomia normale e njeriut	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-14-IV-0336-25 Barnat mjekësore	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-14-IV-0337-25 Procesi i ushqyerjes për të moshuarit	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-14-IV-0338-25 Përkujdesja shëndetësore për të moshuarit.....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-14-IV-0339-25 Përkujdesja sociale për të moshuarit	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-14-IV-0340-25 Aktivitetet argëtuese dhe edukuese për të moshuarit	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-14-IV-0341-25 Mjedis fizik i sigurt për të moshuarit	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-14-IV-0342-25 Respektimi i të drejtave për të moshuarit	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	16
NjN-14-IV-0343-25 Komunikimi me familjarët/ të afërmit e të moshuarit	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	19
NjN-14-IV-0344-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e kujdesit për të moshuarit.....	20
Rezultatet e të nxënit në njohuri	20
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	20
Kriteret e vlerësimit	20
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse.....	21
Modalitetet e vlerësimit	21
Informacion shtesë	22
SHËNIM	22

Emërtimi i kualifikimit	Shërbime kujdesi për të moshuar			Kodi
Kohëzgjatja	6000 orë nocionale	Niveli	Niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	K-U-IV-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK , është përgatitja e individëve për t’u punësuar si menaxher të mesëm, në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me fushën e shërbimeve të kujdesit për të moshuar dhe zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar” të nivelit IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës që përkon me nivelin profesional teknik/menaxher në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në institucione që ofrojnë shërbime sociale/shëndetësore dhe kujdesi për të moshuar, në qendra rezidenciale ose ditore, në shërbimet komunitare të përkujdesjes, në klinikë, spitale etj. Gjithashtu individ i mund të krijojë një biznes në fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të moshuarit. Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, i jep individit të drejtën e Diplomës së Maturës Shtetërore Profesionale. Me përfundimin e këtij niveli, individ ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.			
Ofruesit	<i>Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.</i>			
Data e validimit	Korrik 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	U-IV-15; U-IV-20			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm, në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të ruajë etikën dhe respektin ndaj personave me të cilët bashkëpunon;
6. Të ruajë etikën dhe sjelljen me personat për të cilët kujdeset;
7. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
8. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
9. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
10. Ta dojë punën që bën;
11. Të ketë vullnet për punën që angazhohet;
12. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
13. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
14. Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
15. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
16. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
17. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
18. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
19. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
20. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
21. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
22. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
23. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave;

24. Të jetë i aftë të bëjë vetëvlerësimin e tij sipas kapaciteteve që ofron.

NjN-14-IV-0333-25 Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës në shërbime kujdesi për të moshuar

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të politikave të mbrojtjes për të moshuarit;
2. Të shpjegojë detyrat dhe përgjegjësitë e kujdestarit për të moshuar;
3. Të shpjegojë rëndësinë e shërbimit socio-shëndetësor për të moshuarit;
4. Të klasifikojë shërbimet socio-shëndetësore për të moshuarit, sipas llojit të tyre;
5. Të përshkruajë institucionet e shërbimit të kujdesit për të moshuar sipas tipologjive;
6. Të shpjegojë organizimin e strukturave të përkujdesjes social-shëndetësore për të moshuar;
7. Të përshkruajë masat për mbrojtjen e shëndetit personal sipas protokolleve shëndetësore;
8. Të përshkruajë mënyrat e marrjes së informacionit nga burime të ndryshme në funksion të shërbimit socio-shëndetësor për të moshuarin;
9. Të përshkruajë hapat e organizimit të vendit të punës;
10. Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të prioritetëve të punës;
11. Të përshkruajë teknikat dhe rëndësinë e menaxhimit të kohës;
12. Të shpjegojë rëndësinë e veshjes së uniformës në vendin e punës;
13. Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe ndarjes së detyrave;
14. Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit dhe menaxhimit të burimeve materiale;
15. Të përshkruajë funksionet dhe përdorimet e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të punës;
16. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve dhe pajisjeve;
17. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të hierarkisë;
18. Të shpjegojë format e bashkëpunimit me kolegët dhe të tretë;
19. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
20. Të shpjegojë rëndësinë dhe rubrikat e një plani pune;
21. Të përshkruajë fazat e hartimit dhe zbatimit të një plan veprimi individual;
22. Të përshkruajë formatet, mënyrat e dokumentimit dhe raportimit të punës;
23. Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të rregullave të punës në grup.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin në fuqi për shërbimet e kujdesit për të moshuar;
2. Të organizojë punën në shërbime kujdesi për të moshuar;
3. Të menaxhojë burimet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve të kujdesit për të moshuar;
4. Të hartojë dhe ruajë dokumentacion e punës;
5. Të kryejë dokumentime dhe raportime për realizimin e detyrave.

Kriteret e vlerësimit

- Monitoron zbatimin e politikave të mbrojtjes sociale mbi moshimin sipas legjislacionit në fuqi;

- Mbikëqyr zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të kujdestarit për të moshuar sipas rregullores së brendshme;
- Ofron shërbim socio-shëndetësor për të moshuarin sipas standardeve;
- Mbikëqyr zbatimin e masave për mbrojtjen e shëndetit personal, sipas protokolleve shëndetësore;
- Mbikëqyr përditësimin e njohurive për aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Mbikëqyr organizimin në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Mbikëqyr planifikimin e punës sipas prioriteteve;
- Vesh uniformen në vendin e punës;
- Planifikon mjetet dhe materialet e nevojshme për punë në përputhje me detyrën përkatëse;
- Përzgjedh mjetet dhe pajisjet e punës sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Menaxhon në mënyrë efikase, mjetet, pajisjet dhe materialet;
- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme sipas detyrës përkatëse;
- Përzgjedh burimet njerëzore të nevojshme sipas kualifikimit të kërkuar;
- Menaxhon në mënyrë efikase burimet njerëzore;
- Bashkëpunon me kolegët dhe të tretë në realizimin e veprimtarive sipas rastit;
- Harton dhe ruan dokumentacionin e punës sipas rregullores së brendshme;
- Raporton rregullisht tek eprori sipas formateve përkatëse.

NjN-14-IV-0334-25 Sigurimi i higjienës për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e kujdesit higjieno-sanitar të të moshuarit;
2. Të përshkruajë teknikat në procesin e larjes së të moshuarit;
3. Të përshkruajë rëndësinë e përshtatjes së veshjes sipas stinës dhe nevojave të të moshuarit;
4. Të përshkruajë teknikat e ndërrimit të veshjeve të të moshuarit;
5. Të përshkruajë rëndësinë e procesit të larjes së rrobave dhe biankerive;
6. Të përshkruajë procesin dhe rëndësinë e larjes së duarve në parandalimin e infeksioneve;
7. Të shpjegojë rëndësinë e ndërgjegjësimin të të moshuarit për ruajtjen e higjienës personale;
8. Të përshkruajë llojet e infeksioneve;
9. Të listojë rrugët e përhapjes së infeksioneve;
10. Të shpjegojë mënyrat e parandalimit të sëmundjeve infektive;
11. Të listojë sëmundjet infektive më të shfaqura në moshën e tretë;
12. Të listojë simptomat që i moshuari shfaq nga sëmundjet infektive;
13. Të listojë pasojat në shëndetin e të moshuarit për shkak të sëmundjeve infektive;
14. Të shpjegojë konceptet asepsi dhe rregullat aseptike;
15. Të përshkruajë mënyrat e ruajtjes së higjienës së ambientit rrethues;
16. Të përshkruajë metodat e izolimit dhe rëndësinë e tij në rast sëmundjesh infektive të të moshuarit;
17. Të listojë pajisjet dhe veshjet e posaçme të punës gjatë përkujdesjes për një të moshuar me sëmundje infektive;

18. Të përshkruajë format e trajtimit të produkteve apo mjeteve që përdoren nga i moshuari me sëmundje infektive;
19. Të përshkruajë metodat fizike të dezinfektimit edhe sterilizimit;
20. Të përshkruajë fazat e sterilizimit;
21. Të shpjegojë rëndësinë e ndërgjegjësimit të të moshuarit për respektimin e këshillave nga mjeku për probleme të ndryshme të shëndetit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë procesin e larjes, veshjes/zhveshje për të moshuarin;
2. Të zbatojë rregullat e asepsisë gjatë pastrimit, dezinfektimit, sterilizimit etj.;
3. Të ndërgjegjësojë të moshuarin për zbatimin e këshillave mjekësore dhe ruajtjen e higjienës personale;
4. Të marrë masa parandaluese për përhapjen e sëmundjeve infektive.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e kujdesit higjieno-sanitar të të moshuarit;
- Kryen procesin e larjes së të moshuarit sipas teknikës dhe gjendjes së të moshuarit;
- Përshtat veshjet sipas stinëve;
- Kryen ndërrimin e veshjeve të të moshuarit sipas teknikës;
- Kryen larjen e rrobave dhe biankerive sipas etiketave dhe llojit të tyre;
- Realizon larjen e duarve për parandalimin e infeksioneve sipas rregullave;
- Realizon larjen kirurgjikale të duarve sipas rregulloreve të procesit përkatës;
- Ndërgjegjëson të moshuarin për ruajtjen e higjienës personale;
- Parandalon rrugët e përhapjes së infeksioneve, sipas protokollit;
- Merr masa për parandalimin e sëmundjeve infektive sipas protokollit;
- Kryen pastrimin, dezinfektimin, sterilizimin etj. sipas rregullave të asepsisë;
- Përkujdeset për të moshuarin gjatë izolimit, në rast sëmundjesh infektive, sipas protokollit;
- Ndërgjegjëson të moshuarin për respektimin e këshillave mjekësore lidhur me shëndetin sipas rastit.

NjN-14-IV-0335-25 Anatomia normale e njeriut

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë sistemet në trupin e njeriut;
2. Të përshkruajë sistemin kockor të njeriut;
3. Të listojnë elementët e artikulacioneve;
4. Të listojë llojet e muskujve;
5. Të listojë organet që përbëjnë sistemin tretës;
6. Të listojë organet që përbëjnë sistemin respirator;
7. Të listojë organet që përbëjnë sistemin kardio - vaskular.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë identifikimin e kockave dhe artikulacioneve të trupit të njeriut;
2. Të kryejë identifikimin e muskujve në trupin e njeriut;
3. Të kryejë identifikimin e organeve të sistemin tretës, respirator dhe kardio - vaskular.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë sistemet në trupin e njeriut;
- Identifikon saktë llojet e kockave në trupin e njeriut;
- Identifikon saktë artikulacionet në trupin e njeriut;
- Identifikon saktë llojet e muskujve në trupin e njeriut;
- Identifikon saktë organet që përbëjnë sistemin tretës;
- Identifikon saktë organet që përbëjnë sistemin respirator;
- Identifikon saktë organet që përbëjnë sistemin kardio – vaskular.

NjN-14-IV-0336-25 Barnat mjekësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë format farmaceutike të barnave;
2. Të përshkruajë konceptin e dozimit të barnave;
3. Të listojë rregullat e kujdesit në përdorimin e barnave (afatet dhe kushtet e ruajtjes);
4. Të shpjegojë rrugët e marrjes së barnave;
5. Të listojë llojet e barnave;
6. Të shpjegojë format e alergjisë medikamentoze dhe efektet e padëshiruara të barnave.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të ruajë dhe administrojë barnat sipas rregulloreve dhe përcaktimit të etiketave të tyre;
2. Të zbatojë udhëzimet e mjekut për dozimin e duhur të barnave;
3. Të monitorojë të moshuarin gjatë dhënies së barnave.

Kriteret e vlerësimit

- Ruan barnat sipas standardeve dhe përcaktimit të etiketave të tyre;
- Administron barnat sipas standardeve dhe përcaktimit në etiketat përkatëse;
- Dozon barnat sipas udhëzimit të mjekut;
- Monitoron të moshuarin gjatë dhënies së barnave;
- Lajmëron mjekun, në rast të shfaqjes së efekteve të padëshiruara të barnave;
- Jep ndihmën e parë në rast alergjie medikamentoze sipas protokollit mjekësor;
- Dokumenton çdo veprimtari me barnat sipas formateve të miratuara.

NjN-14-IV-0337-25 Procesi i ushqyerjes për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e hartimit të menu-së ushqimore;
2. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me mjekë dhe dietologë për hartimin e menu-së;
3. Të shpjegojë procedura dhe rëndësinë e sigurimit të produkteve ushqimore;
4. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së vlerave ushqimore;
5. Të shpjegojë procesin e përgatitjes së ushqimit për të moshuarin;
6. Të shpjegojë mënyrat e shërbimit të ushqimit për të moshuarin;
7. Të shpjegojë procesin e ushqyerjes së të moshuarit;
8. Të përshkruajë rëndësinë e pastrimit dhe dezinfektimit të mjeteve dhe pajisjeve të ushqyerjes;
9. Të shpjegojë teknikat e ofrimit të ndihmës së parë gjatë ushqyerjes;
10. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të orareve në shërbimin e vakteve;
11. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e ruajtjes së kampionit ushqimor.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të bashkëpunojë me mjekë dhe dietologë në hartimin e menu-së ushqimore;
2. Të plotësojë nevojat bazë për ushqim për të moshuarin;
3. Të përgatisë ushqimin për të moshuarin;
4. Të demonstrojë ofrimin e ndihmës së parë gjatë ushqyerjes;
5. Të zbatojë oraret në shërbimin e vakteve të të moshuarit;
6. Të pastrojë dhe dezinfektojë mjetet dhe pajisjet e ushqyerjes;
7. Të ruajë në kushte optimale kampionin ushqimor.

Kriteret e vlerësimit

- Bashkëpunon me ekipin multidisciplinar për hartimin e menu-ve ushqimore sipas rregullores së brendshme;
- Dakordëson menu-në ushqimore me të moshuarit/familjarët sipas dëshirës dhe gjendjes shëndetësore;
- Zbaton menu-në e përditshme ushqimore duke respektuar vlerat dhe kaloritë ditore në përputhje me moshën dhe gjendjen shëndetësore;
- Përgatit ushqim për të moshuarit sipas menu-së ushqimore;
- Ushqen të moshuarin, duke zbatuar teknikat e duhura, sipas aftësive dhe nevojave shëndetësore;
- Demonstron ofrimin e ndihmës së parë gjatë ushqyerjes;
- Mirëmban në kushtet optimale të higjienës aksesoret e nevojshëm që përdoren në ofrimin e shërbimeve, sipas protokollit;
- Ruan kampionin ushqimor në kushtet e përshtatshme, sipas standardeve.

NjN-14-IV-0338-25 Përkujdesja shëndetësore për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e informimit në kohë për gjendjen aktuale shëndetësore të të moshuarit;
2. Të përshkruajë etapat e plotësimit të dokumentacionit të ecursisë shëndetësore të të moshuarit;

3. Të shpjegojë normën e parametrave jetësorë të të moshuarit;
4. Të shpjegojë rëndësinë e këshillimit me mjekun për problemet shëndetësore të të moshuarit;
5. Të përshkruajë situata patologjike dhe pasojat mbi gjendjen klinike të sëmundjes së të moshuarit;
6. Të listojë llojet e sëmundjeve më të shpeshta në moshat e treta;
7. Të shpjegojë rëndësinë e sensibilizimit të të moshuarve mbi mënyrën e jetesës dhe ushqyerjen si faktor parandalimi të sëmundjeve;
8. Të shpjegojë ndikimin e aktiviteteve fizike në shëndetin e të moshuarit;
9. Të shpjegojë hapat që duhet të ndërmerren për përgatitjen, ruajtjen dhe sigurimin e një të moshuari gjatë një vizite mjekësore, analize apo ndërhyrje kirurgjikale;
10. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes dhe instalimit të një aparati aerosol;
11. Të shpjegojë rëndësinë e kujdesit paliativ.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të menaxhojë parametrat jetësorë të të moshuarit;
2. Të përkujdeset për gjendjen shëndetësore të të moshuarit;
3. Të dokumentojë dhe raportojë mbi gjendjen shëndetësore të të moshuarit;
4. Të ndërgjegjësojë të moshuarin për kujdesin ndaj shëndetit.

Kriteret e vlerësimit

- Monitoron plotësimin e dokumentacionit mbi ecurinë e shëndetit të të moshuarit sipas formateve;
- Informon në kohë mjekun për gjendjen aktuale shëndetësore të të moshuarit;
- Monitoron ruajtjen në normë të parametrave jetësorë sipas protokollit;
- Informon mjekun për problemet shëndetësore të të moshuarit;
- Realizon takime sensibilizuese me të moshuarit për kujdesin ndaj shëndetit;
- Përkujdeset për shëndetin e të moshuarit me sëmundje të ndryshme sipas procedurës dhe llojit të sëmundjes;
- Kryen matjen e parametrave jetësor sipas procedurës;
- Sensibilizon të moshuarin mbi mënyrën e jetesës dhe ushqyerjen si faktor parandalimi të sëmundjeve;
- Zhvillon aktivitete fizike për të moshuarit sipas gjendjes shëndetësore;
- Zbaton hapat për përgatitjen, ruajtjen dhe sigurimin e të moshuarit gjatë kryerje së vizitave mjekësore, analizave apo ndërhyrjeve kirurgjikale sipas procedurave të paracaktuara;
- Përgatit dhe instalon aparatin e aerizimit sipas procedurës;
- Menaxhon në kohë, rastet emergjente të të moshuarit;
- Menaxhon rastet e kujdesit paliativ sipas nevojave specifike.

NjN-14-IV-0339-25 Përkujdesja sociale për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e marrëdhënies së besimit me të moshuarit;
2. Të përshkruajë rëndësinë e të dëgjuarit aktiv në punën me të moshuarit;
3. Të përshkruajë mënyrat e identifikimit të nevojave sociale të të moshuarit;
4. Të përshkruajë mënyrat e identifikimit të pikave të forta/të dobëta të të moshuarit;
5. Të përshkruajë faktorët që ndikojnë në izolimin social, vetminë, gjendjen emocionale të të moshuarit;
6. Të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit të gjendjes psiko-sociale të të moshuarit përmes vëzhgimeve dhe bisedave;
7. Të përshkruajë kuptimin e rrjeteve mbështetëse në punën me të moshuarit dhe rëndësinë e tyre;
8. Të përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të empatisë të të moshuarit;
9. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të vendimeve dhe zgjedhjeve të të moshuarit;
10. Të shpjegojë mënyrat e ofrimi të mbështetjes emocionale të të moshuarit;
11. Të përshkruajë rëndësinë e inkurajimit të të moshuarit për të shprehur ndjenjat dhe emocionet e tyre;
12. Të përshkruajë mënyrat për të identifikuar dhe adresuar shenja të varësisë emocionale;
13. Të përshkruajë rëndësinë e përfshirjes sociale të të moshuarit;
14. Të listojë faktorët e riskut për neglizhim, abuzim etj..

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të identifikojë nevojat sociale të të moshuarit;
2. Të vlerësojë gjendjen psiko-sociale të të moshuarit;
3. Të identifikojë rrjetet mbështetëse të të moshuarit;
4. Të zhvillojë empatinë të të moshuarit;
5. Të ofrojë mbështetje emocionale për të moshuarit;
6. Të inkurajojë të moshuarit të shprehin ndjenjat dhe mendimet e tyre;
7. Të përfshijë të moshuarit në aktivitete të ndryshme;
8. Të identifikojë faktorët e riskut për neglizhim dhe abuzim;
9. Të ndërhyjë në rastet kur konstatohet varësi emocionale.

Kriteret e vlerësimit

- Ndërton marrëdhënie besimi me të moshuarit sipas kodit të etikës profesionale;
- Identifikon nevojat sociale të të moshuarit sipas instrumenteve të vlerësimit;
- Identifikon pikat e dobëta/pikat e forta të të moshuarit sipas protokollit të punës;
- Nxit të moshuarin për përmirësimin e pikave të dobëta sipas planit individual;
- Vlerëson gjendjen psiko-sociale të të moshuarit përmes vëzhgimit dhe bisedave;
- Ndihejmon të moshuarit në zhvillimin e empatisë përmes teknikave psiko-sociale;
- Identifikon rrjetet mbështetëse të të moshuarit, përmes bisedave me të apo familjarët;

- Inkurajon të moshuarit të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre përmes ushtrimeve psikosociale;
- Përfshin të moshuarit në aktivitete të ndryshme sipas kalendarit dhe dëshirave;
- Identifikon faktorët e riskut për abuzim fizik, seksual, psikologjik, ekonomik, përmes instrumenteve të punës;
- Identifikon faktorët e riskut për neglizhim apo përjashtim social përmes instrumenteve të punës;
- Adreson shenja të varësisë emocionale të të moshuarit.

NJN-14-IV-0340-25 Aktivitetet argëtuese dhe edukuese për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e aktiviteteve argëtuese/edukuese të përshtatshme për moshën e tretë;
2. Të përshkruajë rëndësinë e hartimit të planit të aktiviteteve argëtuese/edukuese;
3. Të identifikojë format e bashkëpunimit me të moshuarin/familjarët/të afërmit për hartimin e kalendarit të aktiviteteve;
4. Të përshkruajë masat dhe format e organizimit të aktiviteteve;
5. Të përshkruajë rëndësinë e përfshirjes së të moshuarit në vendimmarrjen për aktivitetet që organizohen;
6. Të përshkruajë mënyrat e marrjes së informacionit për aktivitetet e preferuara të të moshuarit;
7. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e informimit për ecurinë e aktiviteteve;
8. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kalendarit të festave zyrtare/ditëlindjeve;
9. Të përshkruajë rëndësinë e aktiviteteve argëtuese dhe edukative në ndërveprimin mes të moshuarve;
10. Të shpjegojë rëndësinë e aktiviteteve në përmirësimin e gjendjes psiko-emocionale të të moshuarit;
11. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e informimit për përshtypjet e të moshuarit mbi aktivitetet;
12. Të shpjegojë mënyrat e marrjes së përshtypjeve nga i moshuari për aktivitetet e kryera;
13. Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së aktiviteteve sipas kufizimeve fizike, mendore apo shqisore të të moshuarve;
14. Të përshkruajë mënyrat për të siguruar akses të barabartë në aktivitete për të gjithë të moshuarit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të hartojë kalendarin e aktiviteteve për të moshuarit për festat zyrtare/ditëlindje;
2. Të organizojë aktivitete argëtuese/edukuese për të moshuarit;
3. Të mbështesë të moshuarin në pjesëmarrje të aktiviteteve.

Kriteret e vlerësimit

- Harton planin e aktivitetit argëtues/edukues në kohë sipas formatit përkatës;

- Bashkëpunon me të moshuarin/familjarët/të afërmit për hartimin e kalendarit të aktiviteteve sipas nevojave;
- Organizon/mbikëqyr aktivitetin argëtues/edukues të përshtatshëm për moshën e tretë sipas kalendarit;
- Motivon të moshuarin për të marrë pjesë në aktivitete argëtuese/edukuese sipas rastit;
- Përfshin të moshuarit në vendimmarrje lidhur me aktivitetet sipas rastit;
- Kryen veprimtari argëtuese/edukuese në përputhje me nevojat e të moshuarit;
- Merr nga i moshuari përshtypje për aktivitetet e kryera nëpërmjet metodave të ndryshme;
- Raporton për ecurinë e aktiviteteve sipas formatit të raportimit;
- Zbaton në kohë kalendarin e festave zyrtare/ditëlindje;
- Përshtat aktivitetet sipas kufizimeve fizike, shqisore apo mendore të të moshuarve në përputhje me rekomandimet mjekësore dhe psikologjike;
- Siguron akses të barabartë në aktivitete për të gjithë të moshuarit sipas parimeve të përfshirjes sociale.

NJN-14-IV-0341-25 Mjedis fizik i sigurt për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e një mjedisi të përshtatur në infrastrukturë;
2. Të përshkruajë rëndësinë e identifikimit të rrezeve të mundshme në ambient për të moshuarin;
3. Të përshkruajë rëndësinë e arredimit dhe organizimit të brendshëm të mjedisit;
4. Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së infrastrukturës së nevojshme për të moshuarit me nevoja të veçanta;
5. Të shpjegojë rëndësinë e informimit dhe udhëzimit të të moshuarit për përdorimin e ambienteve;
6. Të shpjegojë ndikimin e kushteve fizike për sigurinë dhe aksesin e të moshuarit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të organizojë mjedisin e brendshëm dhe infrastrukturën e përshtatshme për të moshuarin;
2. Të parashikojë rreziqet e mundshme në mjedisin fizik për të moshuarin;
3. Të përshtatë mjedisin fizik me infrastrukturën e nevojshme për të moshuarin;
4. Të informojë të moshuarin për rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të ambienteve.

Kriteret e vlerësimit

- Përshtat infrastrukturën e nevojshme për të moshuarit sipas standardeve;
- Përshtat infrastrukturën e nevojshme për të moshuarit me nevoja të veçanta, sipas standardeve;
- Identifikon në kohë rreziqet e mundshme në mjedisin fizik për të moshuarin;
- Organizon mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm sipas standardeve;
- Përshtat arredimin me mjedisin sipas standardeve;
- Orienton të moshuarin për përdorimin e ambienteve sipas nevojave të tyre;
- Merr masa për parandalimin e rrezeve të mundshme në mjedisin fizik;
- Identifikon rreziqet e mundshme në rastet emergjente.

NjN-14-IV-0342-25 Respektimi i të drejtave për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të ligjit në fuqi mbi të drejtat e të moshuarit;
2. Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së një raporti konfidencial dhe të besueshëm;
3. Të shpjegojë format dhe rëndësinë e respektimit të autonomisë së të moshuarit;
4. Të shpjegojë rëndësinë e informimit të të moshuarit mbi të drejtat dhe detyrimet e tij;
5. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e përfshirjes së të moshuarit në vendimmarrje;
6. Të listojë format e abuzimit;
7. Të shpjegojë mënyrat e parandalimit të rasteve të abuzimit dhe rëndësia e tij;
8. Të shpjegojë mënyrat e raportimit të abuzimeve dhe rëndësinë e tij;
9. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të privatësisë së të moshuarit;
10. Të shpjegojë rëndësinë e sigurisë fizike dhe emocionale gjatë punës me të moshuarin;
11. Të përshkruajë rëndësinë e trajtimit të të moshuarit me dinjitet gjatë ofrimit të shërbimit;
12. Të shpjegojë rëndësinë e trajtimit në mënyrë të barabartë të të moshuarit pavarësisht gjinisë, përkatësisë fetare, etnike, kulturore, gjendjes shëndetësore etj.;
13. Të shpjegojë mënyrat e raportimit në rast të shkeljes së të drejtave.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë ligjin në fuqi mbi të drejtat/detyrimet e të moshuarit;
2. Të përfshijë të moshuarin në vendimmarrje;
3. Të parandalojë rastet e abuzimit me të moshuarit;
4. Të trajtojë të moshuarit me dinjitet dhe në mënyrë të barabartë.

Kriteret e vlerësimit

- Raporton shkeljet e të drejtave të të moshuarit sipas protokollit;
- Trajton në mënyrë të barabartë të moshuarit sipas kodit të etikës profesionale;
- Trajton të moshuarit me dinjitet gjatë shërbimit në përputhje me parimet e etikës;
- Ofron mbështetje emocionale për të moshuarin gjatë shërbimit sipas standardeve;
- Respekton privatësinë e të moshuarit sipas parimit të konfidencialitetit;
- Parandalon dhe raporton rastet e abuzimit sipas standardit;
- Respekton autonominë e të moshuarit në përputhje me etikën profesionale;
- Përfshin të moshuarit në proceset e vendimmarrjes në varësi të gjendjes së tyre shëndetësore;
- Krijon marrëdhënie konfidencialiteti dhe besimi me të moshuarin sipas parimeve profesionale;
- Informon të moshuarin për të drejtat dhe detyrat sipas legjislacionit në fuqi.

NjN-14-IV-0343-25 Komunikimi me familjarët/ të afërmit e të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarve;

2. Të shpjegojë format e bashkëpunimit me familjarët për ecurinë e të moshuarit;
3. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të takimeve periodike me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarit;
4. Të argumentojë rëndësinë e informimit të familjarëve për të drejtat dhe detyrat e tyre;
5. Të shpjegojë mënyrat e ndërmjetësimit dhe menaxhimit të konflikteve;
6. Të dallojë pengesat në procesin e komunikimit me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarve;
7. Të shpjegojë rëndësinë e mbështetjes së familjarëve të të moshuarit që është në prag të vdekjes;
8. Të shpjegojë mënyrat e asistimit të familjarëve në rast fatkeqësie.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të komunikojë me familjarët, të afërmit ose miqtë për ecurinë e të moshuarit;
2. Të planifikojë takime periodike me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarit;
3. Të menaxhojë konfliktet dhe pengesat gjatë komunikimit me familjarët e të moshuarit;
4. Të mbështesë familjarët e të moshuarit në rast fatkeqësie.

Kriteret e vlerësimit

- Komunikon me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarve sipas formave të përcaktuara;
- Bashkëpunon me familjarët për ecurinë e të moshuarit sipas nevojave;
- Organizon takime me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarit në mënyrë periodike;
- Informon familjarët për të drejtat dhe detyrat e tyre sipas ligjit në fuqi;
- Menaxhon konfliktet sipas procedurave të përcaktuara në protokolle/standarde;
- Zgjidh pengesat gjatë komunikimit me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarve sipas situatës;
- Mbështet familjarët e të moshuarit në prag të vdekjes sipas standardeve;
- Asiston familjarët në rast fatkeqësie sipas nevojave.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet e Kodit të Etikës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit efektiv gjatë punës;
3. Të listojë kanalet e komunikimit dhe përdorimin e tyre;
4. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
5. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
6. Të përshkruajë parimet e komunikimit ndër personal dhe ndër institucional;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), si formë komunikimi;
8. Të shpjegojë teknika të motivimit të stafit;
9. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me kolegë, eprorë etj. gjatë punës;

10. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare, etj.;
11. Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së intonacionit të zërit në komunikim;
12. Të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit aktiv;
13. Të shpjegojë parimet e punës në grup;
14. Të argumentojë rëndësinë e mos përfshirjes ndërpersonale në raport me të moshuarin;
15. Të analizojë rëndësinë e ruajtjes dhe përdorimit të të dhënave mbi të moshuarin.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale me të moshuarit/kolegët;
2. Të përdorë kanale të ndryshme komunikimi në punën me të moshuarit;
3. Të zbatojë parimet e punës në grup;
4. Të bashkëpunojë me aktorë të tjerë.

Kriteret e vlerësimit

- Komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, me të moshuarit dhe kolegët;
- Zbaton parimet e etikës profesionale;
- Përdor terminologji të përshtatshme profesionale sipas kodit të etikës;
- Përdor me korrektësi gjuhën e trupit në përputhje me situatën;
- Komunikon me shkrim sipas rregullave të korrespondencës zyrtare;
- Përdor TIK gjatë komunikimit sipas rregullit;
- Zbaton teknikat e zgjidhjes së konflikteve dhe mendimit kritik;
- Ruan integritetin e të dhënave të të moshuarve dhe konfidencialitetin e tyre sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton teknika për motivimin e stafit;
- Respekton barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Ruan marrëdhënie profesionale në përputhje me parimet etike;
- Zbaton parimet e punës në grup sipas rregullores së punës;
- Bashkëpunon me aktorë të tjerë sipas rastit.

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet bazë të Kodit të Punës;
2. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit Tatimor në fuqi;
3. Të shpjegojë mënyrat e plotësimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
4. Të argumentojë rëndësinë e informimit nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
5. Të shpjegojë metodologjinë e monitorimit të konsumit të produkteve;
6. Të shpjegojë llojet e faturave dhe procedurat e plotësimit të tyre;

7. Të shpjegojë format e blerjes së mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
8. Të shpjegojë mënyrat dhe elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve, produkteve;
9. Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare etj.);
10. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte;
11. Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së inventarizimit për mjete, materiale, pajisje, produkte etj.;
12. Të identifikojë elementet e llogaritjes së çmimit përfundimtar për shërbimet e ofruara;
13. Të rendisë llojet e procesverbaleve/dokumenteve për dorëzimin e shërbimit;
14. Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
15. Të shpjegojë teknikat e marketingut;
16. Të shpjegojë metodat e zhvillimit profesional;
17. Të shpjegojë mënyrat e transmetimit të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
18. Të argumentojë rëndësinë e trajnimeve dhe kurseve lidhur me veprimtarinë e punës;
19. Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të karrierës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë detyra administrative dhe tregtare;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut për promovim;
3. Të zhvillohet për ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton Kodin e Punës dhe legjislacionin Tatimor;
- Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike sipas rregullave;
- Merr periodikisht informacion nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
- Përgatit ofertën për një shërbim sipas çmimeve aktuale të tregut;
- Kryen blerjen e mjeteve, materialeve, produkte dhe pajisjeve të nevojshme sipas planifikimit;
- Gjeneron faturat për shërbimit e kryer sipas sistemit të fiskalizimit;
- Monitoron konsumin e produkteve;
- Kryen inventarizimin e mjeteve, materialeve, pajisjeve, produkteve sipas rregullores së brendshme;
- Plotëson dhe arkivon dokumentacionin e punës sipas legjislacionit;
- Përdor dokumentet/procesverbalet e duhura për dorëzimin e shërbimit të ofruar;
- Raporton periodikisht për punën e kryer;
- Zbaton teknikat e marketingut për shërbimet socio-shëndetësore;
- Përzgjedh mjetet e marketingut sipas llojit të shërbimit;
- Merr vazhdimisht pjesë në trajnime, kurse, aktivitete të tjera për zhvillimin profesional dhe të karrierës;
- Përdor teknologjinë bashkëkohore për proceset e punës në shërbimet socio-shëndetësore sipas rregullave;

- Informon në kohë bashkëpunëtorët për aplikimin e teknikave të reja në shërbimet socio-shëndetësore;
- Siguron trajnime për stafin sipas nevojave profesionale;
- Kryen vlerësimin e performancës së stafit sipas rregullores së brendshme;
- Përcakton metodat e zhvillimit profesional;
- Ndjek trajnimet dhe kurse të ndryshme profesionale.

NjN-14-IV-0344-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e kujdesit për të moshuarit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
2. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të përshkruajë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikës në terren;
5. Të shpjegojë planin e evakuimit në raste emergjence;
6. Të përshkruajë rregullat e MZSH-së;
7. Të përshkruajë protokollet e trajtimit të mbetjeve spitalore ose urbane;
8. Të përshkruajë mënyrat të pastrimit dhe dezinfektimit të mjeteve/pajisjeve të punës;
9. Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit të punës në raste të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
10. Të përshkruajë mënyrën e ruajtjes dhe magazinimit të materialeve të dëmshme për mjedisin;
11. Të shpjegojë zbatimin e protokolleve në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
12. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe manualin për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
2. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
3. Të mbikëqyrë zbatimin e protokolleve për trajtimin e mbetjeve spitalore ose urbane;
4. Të përdor burimet për një mjedis të qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin në fuqi për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Zbaton manualin përkatës në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Respekton sinjalistikën në terren sipas rregullit;
- Mbikëqyr/Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës përkatëse;
- Mbikëqyr/Zbaton rregullat e MZSH-së sipas rregullores përkatëse;
- Mbikëqyr/Zbaton protokollet për trajtimin e mbetjeve spitalore ose urbane;

- Mbikëqyr pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve/pajisjeve të punës sipas procedurës;
- Koordinon punën në raste të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Mbikëqyr ruajtjen dhe magazinimin e materialeve të dëmshme për mjedisin;
- Zbaton protokollet në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
- Përdor me efikasitet burimet për një mjedisi të qëndrueshëm.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës në shërbime kujdesi për të moshuar	5	NjN-14-IV-0333-25
2	Sigurimi i higjienës për të moshuarit	6	NjN-14-IV-0334-25
3	Anatomia normale e njeriut	10	NjN-14-IV-0335-25
4	Barnat mjekësore	10	NjN-14-IV-0336-25
5	Procesi i ushqyerjes për të moshuarit	10	NjN-14-IV-0337-25
6	Përkujdesja shëndetësore për të moshuarit	20	NjN-14-IV-0338-25
7	Përkujdesja sociale për të moshuarit	10	NjN-14-IV-0339-25
8	Aktivitetet argëtuese dhe edukuese për të moshuarit	5	NjN-14-IV-0340-25
9	Mjedis fizik i sigurt për të moshuarit	3	NjN-14-IV-0341-25
10	Respektimi i të drejtave për të moshuarit	5	NjN-14-IV-0342-25
11	Komunikimi me familjarët/ të afërmit e të moshuarit	5	NjN-14-IV-0343-25
12	Komunikimi dhe etika profesionale	5	NjN-22-IV-0006-24
13	Sipërmarrje dhe edukim karriere	3	NjN-23-IV-0005-24
14	Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e kujdesit për të moshuarit	3	NjN-14-IV-0344-25
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individi i lind e drejta të certifikohet për njësi të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-U-IV-25**

K - Kualifikim

U – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

IV – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-14-IV-0333-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

14 – Numri që identifikon fushën e Njësive të të Nxënit

IV – Shifra që tregon nivelin e Njësive të të Nxënit në strukturën e KSHK

0333 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit